



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 23 gusht 2024  
Nr. ref.: RK 2516/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI198/23**

Parashtrues

**Nevruz Berisha**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së**  
**Aktgjykimit PML.nr. 201/23, i 30 majit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është parashtruar nga Nevruz Berisha me vendbanim në fshatin Bec, Komuna e Gjakovës, (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Ylli Bokshi, avokat nga Komuna e Gjakovës.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [PML.nr. 201/23] të 30 majit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) në lidhje me Aktgjykimin [PA1.nr.1732/22] e 16 shkurtit 2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) dhe Aktgjykimin [P.nr.195/2021] e 14 prillit 2022 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të tij, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me paragrafët 1, 3 (b) dhe (d) të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesi i kërkesës para Gjykatës kërkon vendosjen e masës së përkohshme ndaj ekzekutimit të dënimit të përcaktuar me Aktgjykimin [P.nr.195/2021] e 14 prillit 2022 të Gjykatës Themelore, për shkak se i njëjti tanimë është në ekzekutim.

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 nenit 113 [Juridiksiioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 (Procedimi i kërkesës), 27 (Masat e përkohshme) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullat 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) dhe 44 (Kërkesa për masë të përkohshme) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 01/2023 (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 18 shtator 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën e tij përmes postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) e pranoi më 20 shtator 2023.
7. Më 25 shtator 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës dhe ia dërgoi një kopje të kërkesës kësaj të fundit.
8. Më 26 shtator 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [Nr.GJR.KI198/23] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi gjyqtar raportues, si dhe Vendimit [Nr.KSH.KI198/23] kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Safet Hoxha (kryesues), Nexhmi Rexhepi dhe Enver Peci (anëtarë).
9. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç'rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
10. Më 16 korrik 2024, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi i kërkesës parashtron kërkesë për herë të dytë në Gjykatë. Kërkesa e tij e mëparshme, e regjistruar me numrin KI135/22 ka ndërlidhje të tërthortë me rrethanat e rastit konkret. Parashtruesi i kërkesës në këtë rast kërkoi nga Gjykata vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Pml. nr. 307/2022] të 11 gushtit 2022 të Gjykatës Supreme, përmes së cilës parashtruesi pretendoi se me mos mundësimin e rehabilitimit ligjor për lëndët [PKR.nr.421/12] dhe [P.nr. 71/18], të cilat sipas tij, pas kalimit të afatit të paraparë ligjor ka qenë dashur të fshihen automatikisht nga gjykata *ex-lege* prej evidencës së të dënuarve, i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë. Gjykata përmes Aktvendimit për Papranueshmëri në rastin [KI135/22](#) me parashtrues *Nevruz Berisha*, 12 prillit 2023 shpalli të papranueshme si qartazi të pabazuar kërkesën e të njëjtit, me arsyetimin se Gjykata Supreme, kishte dhënë arsye të bazuara në ligj, duke shpjeguar se përse në rastin konkret është dashur të hedhet poshtë si e palejuar kërkesa e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë.
12. Nga shkresat e lëndës rezulton se më 23 shkurt 2021, Drejtoria për Hetim të Trafikimit me Qenie Njerëzore në Gjakovë kishte paraqitur kallëzim penal ndaj parashtruesit të kërkesës për shkak të veprave penale “*Mundësim ose detyrim në prostitucion*” nga paragrafi 1 i nenit 234 (Mundësimi ose detyrimi në prostitucion) i Kodit Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK) dhe “*Ofrim i lokaleve për prostitucion*” nga paragrafi 1 i nenit 235 (Ofrimi i lokaleve për prostitucion) i KPRK-së sepse u dyshua që gjatë muajit korrik 2020 në Gjakovë kishte ndihmuar të pandehurin D.M., duke ia dhënë në shfrytëzim hotelin e tij “Fontana” në Gjakovë, për ofrimin e shërbimeve seksuale, të cilat i ofronte përmes të dëmtuarës, L.B., me qëllim të mundësimit të prostitucionit.
13. Më 11 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Prokurorinë Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal (në tekstin e mëtejme: Prokuroria Themelore) kundër A.H., Prokuror i kësaj prokurorie, me pretendimin se i njëjti: (i) kishte trajtuar atë në mënyrë të pabarabartë në raport me të njëjtin [D.M] në rastet kur kishte parashtruar kërkesë për vazhdimin e paraburgimit të parashtruesit dhe jo edhe të bashkakuzuarit tjetër D.M; (ii) kishte zhvilluar hetimet në mënyrë të anshme duke ftuar vetëm mbrojtësin e të pandehurit tjetër, D.M., në marrjen e deklaratave të të dëmtuarës dhe dëshmitarëve; si dhe (iii) ishte përpjekur që të mënjanojë provat shfajësuese për parashtruesin e kërkesës duke mos proceduar disa dëshmitarë.
14. Në të njëjtën ditë, nga shkresat e lëndës rezulton se parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Prokurorinë Themelore për “*përgjashtimin e gjyqtarit [Nj.M] për përfaqësimin e aktakuzës ndaj të pand. [N.B] – Çështja penale në Gjykatën Themelore në Gjakovë P.nr. 195/2021*”, të cilën kërkesë, Kryeprokurori i kësaj prokurorie e përcjelli për shqyrtim në Gjykatën Themelore. Në kërkesën e lartcekur, parashtruesi kërkoi që çështjen në fjalë t’ia ndajë në punë ndonjë gjyqtari tjetër sepse gjyqtari i caktuar sipas tij ka vepruar në anësi, mungesë objektiviteti, aplikim selektiv të ligjit dhe me shkelje ligjore dhe kushtetuese.
15. Më 18 qershor 2021, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [AGJ.I.nr.167/21] refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për përgjashtimin e gjyqtarit Nj.M, me arsyetimin se fakti që Gjykata Supreme ka aprovuar kërkesën e mbrojtjes së ligjshmërisë për mos vazhdimin e masës së paraburgimit, duke e lëshuar parashtruesin e kërkesës të mbrohet në liri, nuk përbën bazë për përgjashtimin e gjyqtarit, por kjo është procedurë ligjore si rezultat i përdorimit të mjeteve juridike dhe se sa i përket pretendimit për anësi dhe

mungesë objektiviteti nuk është vërtetuar me asnjë rrethanë që të shkaktojë dyshim të arsyeshëm në paanësinë e gjyqtarit.

16. Më 29 qershor 2021, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore përmes Vendimit [AD.nr.03/2021], refuzoi si të pabazuar ankesën për shkelje disiplinore të parashtruesit të kërkesës kundër prokurorit A.H., sepse konstatoi se nuk ekziston asnjë shkelje disiplinore nga paragrafët 1 dhe 2 të nenit 6 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (në tekstin e mëtejme: Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore) me arsyetimin se: (i) mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës, i caktuar sipas detyrës zyrtare nuk ka qenë i autorizuar në bazë të autorizimit dhe i njëjti nuk ka paraqitur asnjë kërkesë prokurorit që të merr pjesë në marrjen e deklaratës së palëve, deklarata të cilat mund të sfidohen nga i pandehuri dhe mbrojtësi gjatë seancave gjyqësore; (ii) gjykata nuk është e lidhur me propozimin e prokurorit për vazhdimin e masës së paraburgimit pas ngritjes së aktakuzës, por vetëm merr mendim prej tij dhe se kjo nuk përbën shkelje ligjore nëse prokurori nuk pajtohet me kërkesat e avokatit, i cili në raste të tilla ka mundësinë për të atakuar vendimet gjyqësore, siç edhe ka vepruar në rastin konkret; si dhe (iii) si rezultat i provave shfajësuese janë pushuar hetimet ndaj parashtruesit të kërkesës sa i përket veprës penale “Ofrimi i lokaleve për prostitucion” nga paragrafi 1 i nenit 235 të KPRK-së.
17. Më 14 prill 2022, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [P.nr.195/2021] shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale “Mundësim ose detyrim në prostitucion” nga paragrafi 1 i nenit 234 të KPRK-së në bashkëkryerje, dhe e dënoi të njëjtin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muajve, me arsyetimin se me anë të fakteve dhe rrethanave të vërtetuara të rastit, si dhe dëshmime të dëshmitarëve, vërtetohet se i parashtruesi i kërkesës ka kryer veprën penale që i vihet në barrë në bashkëkryerje përmes ndërmjetësimit të klientëve për shfrytëzimin e të dëmtuarës, në këmbim të shumave nga 20 (njëzet) në 50 (pesëdhjetë) euro. Më specifikisht, Aktgjykimi i lartcekur përmend dëshmitarët, të cilëve iu është falur besimi, dhe atyre që nuk iu është falur për të mbështetur fajësinë e parashtruesit të kërkesës, si dhe i në lidhje me pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës theksoi si në vijim:

“1. Gjykata të dëmtuarën e ka marrur në pyetje me anë të skype edhe pse e njëjta ishte në gjykatë por në një sallë tjetër, me arsyetimin se të dëmtuarën në një seancë paraprake ka filluar që ta merr në pyetje në sallë të gjyqimit kur ish-in të gjitha palët, por e dëmtuara ka pasur frik, shqetësim dhe emocion, pastaj mbrojtësja e viktimave e ka bërë një kërkesë që e dëmtuara të qëndrojë në një sallë tjetër dhe gjykata e ka aprovuar kërkesën; 2. Gjykata e ka aprovuar kërkesën e të akuzuarit [N.B] që si dëshmitar të ftohet bashkëshortja e tij [B.B], të njëjtën gjykata e ka dëgjuar në cilësi të dëshmitares, por të njëjtën disa nga palët në procedurë nuk e kanë pyetur me arsyetimin se ka qenë e pranishme në seanca, e gjykata e ka aprovuar pasi që dëshmitarja ka qenë prezent në seancat : fillestare dhe shqyrtimi i dytë, si qytetare; 3. Gjatë mbrojtjes së të pandehurit [N.B], gjatë marrjes në pyetje nga prokurori i shtetit, gjykata i ka lejuar të gjitha pyetjet e parashtruara nga prokurori në drejtim të pandehurit kanë qenë të tërthorta, se të gjitha pyetjet janë parashtruar duke u ndërlidhur me deklaratat e të pandehurit të cilat i ka dhënë në: Polici dhe Prokurori e i pandehuri nuk është përgjigjur asnjëherë as në polici e as në prokurori.”
18. Më 31 maj 2022, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [P.nr.195/2021] të 14 prillit 2022 për shkak të (i) shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale; (ii) vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike; (iii) shkeljes së ligjit penal; si dhe (iv) vendimit lidhur me sanksionet penale dhe

shpenzimeve të procedurës penale, me propozimin që të anulohet aktgjykimi e Gjykatës Themelore dhe t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

19. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës ndër të tjera: (a) pretendoi se gjendja faktike ishte vërtetuar gabimisht sepse aktgjykimi ishte i bazuar në thashetheme siç ishte deklarata e M.T.; (b) theksoi se bashkëshortja e tij nuk kishte prezantuar në shqyrtimin fillestar dhe të dytë andaj duhej të dëgjohej si dëshmitare; (c) u ankua se i pandehuri tjetër D.M. ishte dënuar me dënim më të ulët për kryerje të veprës penale në fjalë në raport me të, i cili ishte dënuar për ndihmë; (d) vuri në pah se aktgjykimi i atakuar ishte përpiluar pas afatit ligjor; si dhe (e) nënvizoi se rrethanë rënduese në vlerësimin e lartësisë së dënimit ishin marrë parasysh veprat penale të mëparshme që nuk prodhojnë më pasoja juridike, prej të cilave sipas tij, dy dënime me kusht kishin arritur rehabilitimin ligjor sipas paragrafit 2.2 të nenit 96 të KPRK-së, ndërsa për dy dënimet me gjobë, neni 96 të KPRK-së, përcakton se *“Pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba ose vërejtja gjyqësore”*.
20. Më 16 shkurt 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1.nr.1732/22] të 16 shkurtit 2023, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi Aktgjykimin [P.nr.195/2021] e 14 prillit 2022 të Gjykatës Themelore, me arsyetimin se aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, ku gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike, të cilën e ka vërtetuar. Më konkretisht, në arsyetimin e Gjykatës së Apelit, u theksua se:

*“Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar. Gjykata e shkallës së parë provat i ka vlerësuar në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.2 të KPPK-së, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par. 6 dhe 7 të KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe çfarë arsye i merr si të provuara dhe të pa provuara. Ajo ka dhënë arsye në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së çështjes juridike penale, veçanërisht të ekzistimit të përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Në arsyetimin e aktgjykimit përkitazi me ngjarjen e kryerjes së veprës penale në fjalë, janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje juridike penale, të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe një herë vlerësimin për këtë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë edhe me mbrojtjen e të akuzuarit [N.B], kështu që përfundimet e gjykatës së shkallës së parë sa i takon mbrojtjes së të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykatë janë të drejta dhe të bazuara me ligj. [...]*

21. Më 27 prill 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit [P.nr.195/21] të 14 prillit 2021 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PA1.1732/22] të 16 shkurtit 2023 të Gjykatës së Apelit, për shkak të: (i) shkeljes së ligjit penal; (ii) shkeljes esenciale të dispozitave penale; (iii) shkeljes së dispozitave të procedurës penale, të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore të atakuara me këtë kërkesë, me propozimin që aktgjykimet në fjalë të ndryshohen ashtu që të lirohet nga aktakuza parashtruesi i kërkesës për veprën penale për të cilën akuzohet dhe të njëjtat aktgjykime t'i anulohet si dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje. Parashtruesi i kërkesës në thelb përsëriti (i) pretendimet ankimore të ankesës së tij të 31 majit 2022 në lidhje me vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve dhe provave; (ii) theksoi se nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim sa i përket e veprës penale, përfshirë ndihmën ose bashkëkryerjen, siç pretendon se ishte theksuar në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore; si dhe (iii) shtoi pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, duke cituar praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese.

22. Më 12 maj 2023, parashtruesi i kërkesës paraqiti parashtrësë për plotësimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë kundër Aktgjykimit [P.nr.195/21] të 14 prillit 2021 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimit [PA1.1732/22] të 16 shkurtit 2023 të Gjykatës së Apelit, ku ngriti pretendimet për (i) paanësinë e prokurorit A.H. të Prokurorisë Themelore gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve, dhe (ii) kërkesën për përjashtimin e këtij prokurori.
23. Më 30 maj 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.201/2023] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [P.nr.195/21] e 14 prillit 2021 të Gjykatës Themelore dhe Aktgjykimin [PA1.1732/22] të 16 shkurtit 2023 të Gjykatës së Apelit, me arsyetimin se në aktgjykimet e kontestuara janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me refuzimin e pyetjeve të parashtruesit të kërkesës, të cilin arsyetim e pranon edhe kjo gjykatë si të ligjshëm. Gjykata Supreme në lidhje me pretendimet e ngritura në plotësimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me kërkesat për përjashtim të prokurorit të çështjes dhe shkresat e tjera, për të cilat ka vendosur kryeprokurori përkatës, vendosi se nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit para saj.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

24. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se me Aktgjykimin e kontestuar i është shkelur e drejta e tij e garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafët 1 dhe 3 (b) dhe (c) të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së.
25. Parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se Aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë në: (i) shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit procedural; dhe (ii) mosarsyetim të vendimit gjyqësor.
26. Sa i përket pretendimit për shkeljen e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit procedural, parashtruesi i kërkesës pretendon se prokurori në çështjen e tij ka zhvilluar hetimet në mënyrë të njëanshme duke favorizuar të pandehurin tjetër D.M., dhe nuk ka ftuar mbrojtësin e tij gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve por vetëm mbrojtësin e të pandehurit të lartcekur, pavarësisht se ai gjendej në paraburgim dhe në këto raste mbrojtja është e detyrueshme. Ai po ashtu, në lidhje me këtë pretendim shprehet se “[...] *me provat e marra në mënyrë kundërkushtetuese nga prokuroria, nuk kanë vërtetuar se kryesi ka kryer veprën penale për të cilën është gjykuar por kanë krijuar bindjen e rreme, dhe përveç se kanë ndikuar në vendimmarrje të njëjtat kanë ndikuar edhe në lartësinë e dënimit për të mbrojturin tim duke shkelur nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe Nenit 6 par.1 dhe 3 (b) dhe (d) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*” Në këtë kontekst, i njëjti e thirret në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) ku elaborohen parimet respektive, gjegjësisht në rastet e Gjykatës, [KI230/19](#) [parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020] dhe [KI103/10](#) [parashtrues *Shaban Mustafa*, Aktgjykim i 20 marsit 2012], si dhe rastet e GJEDNJ-së, [Öcalan kundër Turqisë](#), nr. 46221/99, Aktgjykim i 12 majit 2005; [Bulut kundër Austrisë](#), nr. 17358/90, Aktgjykim i 22 shkurtit 1996; [Yvon kundër Francës](#), nr. 44962/98, Aktgjykim i 24 korrikut 2003; [Dombo Beheer B.V. kundër Holandës](#), nr. 14448/88, Aktgjykimi i 27 tetorit 1993; [Jasper kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 27052/95, Aktgjykimi i 16 shkurtit 2000 dhe 4 (katër) raste të tjera.

27. Përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, parashtruesi i kërkesës, theksoi se Gjykata Themelore në aktgjykimin e saj nuk ka trajtuar fare kundërshtimet e mbrojtjes se cilat kanë qenë veprimet e parashtruesit të kërkesës përmes të cilave ka kryer veprën penale, për të cilën është gjykuar dhe më saktësisht shprehet se: *“Gjykata Themelore në Gjakovë në Aktgjykimin e saj fare nuk ka trajtuar kundërshtimet e mbrojtjes se cilat kanë qenë veprimet e të akuzuarit, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1.nr.1732/2022, të datës 05.04.2023, fare nuk ka trajtuar asnjë pretendim të mbrojtjes për veprimet e parashtruesit të kërkesës që e bëjnë kryes të kësaj veprë , ndërsa Gjykata Supreme nuk është thirrur në kundërshtimet e sa i përket administrimit të provave, mos administrimit të deklaratës së dëshmitarit [P.Th] e cila ka qenë tërësisht shfajësuese. Ndërsa lëshimi i saj në gjendje faktike ka qenë totalisht i gabuar dhe jo kompetencë e saj”*. Në këtë drejtim, parashtruesi konsideron se aktgjykimet e kontestuar kanë shkëlur parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje ngase arsyetimet e dhëna nuk përmbajnë fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre, dhe për këtë mbështetet në praktikën gjyqësore të Gjykatës, respektivisht, në rastet [KI72/12](#), parashtrues *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykim i 5 dhjetorit 2012; dhe [KI135/14](#), parashtrues *“IKK Classic”*, Aktgjykim i 9 shkurtit 2016.
28. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se si rrethana matëse për vlerësimin e lartësisë së dënimit gabimisht është marrë Aktgjykimi [PKR.nr.421/12] i 27 nëntorit 2013, i plotfuqishëm më 9 shkurt 2017 me të cilin ishte dënuar me kusht për 2 (dy) vite, dhe për të cilin dënim, sipas tij, janë plotësuar kushtet për rehabilitimin ligjor më 9 shkurt 2018, me ç’rast shlyhet dënimi nga evidenca e të dënuarve sipas ligjit (*ex-lege*). Në këtë kontekst, i njëjti nënvizon se nëse në lartësinë e dënimit nuk do të ishte marrë parasysh vepra penale për të cilën është arritur rehabilitimi ligjor, atëherë, sipas tij, kjo çështje do të kishte epilog tjetër dhe se gjithsesi gjykatat nuk është dashur të marrin këtë rrethanë si rënduese.
29. Në fund, parashtruesi i kërkesës i kërkon Gjykatës që: *“[...] të trajton këtë çështje me kujdes të veçantë. Është e pabesueshme që gjykatat e tri niveleve të marrin vendime arbitrare pa bërë argumente të qarta dhe të arsyetuara në lidhje me veprimet e parashtruesit të kërkesës dhe me veprimet e ndërmarrura. Është e rëndësishme që ligji dhe procedurat ligjore të respektohen në mënyrë të plotë për të siguruar drejtësi dhe integritet në procesin gjyqësor. Andaj parashtruesit të kërkesës i janë shkëlur nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.

### **Kërkesa për masë të përkohshme**

30. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij para Gjykatës kërkoi nga Gjykata që të vendosë masën e përkohshme për të evituar dëmet e pariparueshme ndaj tij, me arsyetimin si në vijim: *“Duke pasur parasysh që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë P.nr.195/21, i datës 14.02.2022, tani më është në ekzekutim, duke pasur parasysh që parashtruesi i kërkesës ka bërë më të besueshme kërkesën e tij, i lutem kësaj gjykate që të caktoj masë të përkohshme në ekzekutimin e atij vendimi deri në vendosje përfundimtare.”*

## Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

### KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

#### Neni 31

#### [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

*“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*

*2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.*

*[...]*”

### KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

#### Neni 6

#### (E drejta për gjykim të drejtë)

*“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.*

*[...]*

*3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme:*

*[...]*

*b. t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes;*

*c. të mbrohet vetë ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij, ose në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë;*

*[...]*”

### KODI NR. 06/L-074 PENAL I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

#### KAPITULLI II V

#### VEPRAT PENALE DHE PËRGJEGJËSIA PENALE

#### Neni 31

#### (Bashkëkryerja)

*“Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë*

mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale”

## **KAPITULLI VIII PASOJAT JURIDIKE TË DËNIMI**

### **Neni 93 (Pasoja juridike të dënimit)**

- “1. Pasojat juridike të dënimit mund të parashihen vetëm me ligj.
2. Pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba apo vërejtja gjyqësore.
3. Dënimet për disa vepra penale të caktuara mund të kenë si pasojë shuarjen apo humbjen e të drejtave të caktuara ose ndalimin e fitimit të të drejtave të caktuara.”

### **Neni 94 (Fillimi dhe kohëzgjatja e pasojave juridike të dënimit)**

- “1. Pasojat juridike të dënimit fillojnë në ditën kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm.
2. Pasojat juridike të dënimit të cilat kanë të bëjnë me ndalimin e fitimit të disa të drejtave të caktuara nuk mund të zgjasin më tepër se dhjetë (10) vjet nga dita kur dënimi është mbajtur, falur ose kur është bërë parashkrimi, nëse ligji nuk parasheh kohëzgjatje më të shkurtër për pasojat juridike të caktuara.
3. Kur dënimi shlyhet atëherë pushojnë pasojat juridike të dënimit.”

## **KAPITULLI XX VEPRAT PENALE KUNDËR INTEGRITETIT SEKSUAL**

### **Neni 234 (Mundësimi ose detyrimi në prostitucion)**

- “1. Kushdo që rekruton, organizon, ndihmon, mban, fsheh ose kontrollon personin tjetër për qëllime të prostitucionit, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në katër (4) vjet.  
[...]

### **Neni 235 (Ofrimi i lokaleve për prostitucion)**

- “1. Kushdo që me dijeni ofron lokalit, qoftë si pronar i lokalit, qiradhënës, qiramarrës, shfrytëzues ose person përgjegjës, personit tjetër për qëllim të prostitucionit ose mundësimit të prostitucionit, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në katër (4) vjet.  
[...]

## **KAPITULLI VIII PASOJAT JURIDIKE TË DËNIMIT**

### **Neni 93 (Pasoja juridike të dënimit)**

- “1. Pasojat juridike të dënimit mund të parashihen vetëm me ligj. 2. Pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjoba apo vërejtja gjyqësore. 3. Dënimet

*për disa vepra penale të caktuara mund të kenë si pasojë shuarjen apo humbjen e të drejtave të caktuara ose ndalimin e fitimit të të drejtave të caktuara.”*

## **KAPITULLI IX REHABILITIMI DHE ZBULIMI I TË DHËNAVE NGA DOSJA PENALE**

### **Neni 96 (Rehabilitimi ligjor)**

*“1. Me rehabilitimin ligjor dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar, siç parashihet në paragrafin 2. të këtij neni dhe personi i tillë nuk konsiderohet i dënuar.*

*2. Dënimi shlyhet nga evidenca e personit të dënuar pas skadimit të periudhave kohore vijuese, duke vepruar sipas ligjit, nëse personi i dënuar brenda afateve vijuese nuk kryen ndonjë vepër të re penale:*

*[...]*

*2.2. një (1) vit nga dita e skadimit të periudhës së verifikimit në rastin e dënimit me kusht;*

*[...]”.*

## **KODI NR. 04/L-123 I PROCEDURËS PENALE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

### **Neni 132 (Marrja e deklaratës në procedurë paraprak)**

*[...]*

*6. Prokurori i shtetit e njofton me shkrim pesë (5) ditë më herët të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklarata në procedurë paraprake. Kopje e njoftimit i bashkëngjitet shkresave të lëndës.*

*[...]”*

### **Neni 249 (Kundërshtimi i provave)**

*“1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kundërshtim ndaj provave të caktuara në aktakuzë, bazuar në këto arsye:*

*1.1. provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritar;*

*1.2. provat janë në kundërshtim me rregullat nga Kapitulli XVI i këtij Kodi; ose*

*1.3. ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thelbësisht të pambështetshme.*

*2. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që t'i përgjigjet kundërshtimit gojarisht ose me shkrim.*

*3. Për të gjitha provat për të cilat është paraqitur kundërshtim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues merr aktvendim me shkrim të arsyetuar për lejimin ose përjashtimin e provës.*

*4. Provat e papranueshme ndahen nga shkresat dhe mbyllen. Provat e tilla mbahen nga gjykata të ndara nga shkresat dhe provat tjera. Provat e papranueshme nuk mund të shqyrtohen apo të shfrytëzohen në procedurë penale, përveç në rastin e ankesës kundër aktvendimit mbi pranueshmërinë.*

5. Të gjitha provat kundër të cilave nuk është paraqitur kundërshtim janë të pranueshme në shqyrtim gjyqësor, përveç nëse gjykata sipas detyrës zyrtare përcakton se pranueshmëria e provës së caktuar do të cenonte të drejtat e të pandehurit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

6. Secila palë mund të paraqesë ankesë kundër aktvendimit nga paragrafi 3 . të këtij neni. Ankesa duhet të bëhet brenda pesë (5) ditëve nga pranimi i aktvendimit me shkrim.”

### **Neni 361 (Baza e aktgjykimit)**

[...]

2. Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar.”

### **Neni 370 (Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit me shkrim)**

[...]

6. Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit.  
7. Gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të ligjit penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij.

[...]

### **Neni 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë)**

“1. Kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë, pas përfundimit të procedurës penale në formë të prerë mund të paraqitet kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në rastet vijuese:

1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal;

1.2. në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose

1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

[...]

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

31. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

33. Gjykata gjithashtu i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe nenit 49 [Afatet] të Ligjit të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

*"1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*

*2. Individë mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

*"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj."*

34. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është: (i) palë e autorizuar, i cili konteston një akt të një autoriteti publik përkatësisht Aktgjykimin [PML.nr. 201/23] të 30 majit 2023 të Gjykatës Supreme në lidhje me Aktgjykimin [PA1.nr.1732/22] e 16 shkurtit 2023 të Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin [P.nr.195/2021] e 14 prillit 2022 të Gjykatës Themelore; (ii) ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; dhe (iii) ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj; si dhe (v) e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.
35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të së cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Specifikisht, pika d) e paragrafit 1 dhe paragrafi 2 i rregullit 34 të Rregullores së punës përcaktojnë që:

*"(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

*[...]*

*(d) Kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.*

*[...]*

*(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi/ja nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj".*

36. Gjykata fillimisht thekson se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) dhe në praktikën gjyqësore të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “*qartazi e pabazuar*” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih, rastet e GJEDNJ-së [Kemmachev kundër Francës](#), nr. 17621/91, Aktgjykim i 24 nëntorit 1994, paragrafi 44 [Trofimchuk kundër Ukrainës](#), nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005, paragrafi 55; [Mentzen kundër Letonia](#), nr. 71074/01, vendimi i 7 dhjetorit 2004, [Baillard kundër Francës](#), nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008, dhe rastet e Gjykatës [KIO4/21](#), parashtruese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 prillit 2021, paragrafi 26; [KI107/21](#), parashtrues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 tetorit 2021, paragrafi 53; dhe [KIO5/23](#) parashtrues *Branislav Gajin*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2024, paragrafi 51).
37. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht në vlerësimin nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata fillimisht do të rikujtojë esencën e rastit si dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
38. Në këtë aspekt, dhe fillimisht, Gjykata rikujton që rrethanat e rastit konkret ndërlidhen me Aktgjykimin [P.nr.195/2021], e 14 prillit 2022, të Gjykatës Themelore përmes të cilit shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale “*Mundësim ose detyrim në prostitucion*” nga paragrafi 1 i nenit 234 të KPRK-së në bashkëkryerje, dhe e dënoi të njëjtin me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) muajve. Më 16 shkurt 2023, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [PA1.nr.1732/22] të 16 shkurtit 2023, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, me arsyetimin se aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë. Më 27 prill 2023, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, të cilën më pas e plotësoi më 12 maj 2023. Më 30 maj 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml.nr.201/2023] refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit dhe vërtetoi aktgjykimet e shkallës më të ulët, me arsyetimin se në të njëjtat kanë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me refuzimin e pyetjeve të parashtruesit të kërkesës, të cilin arsyetim e pranon edhe kjo gjykatë si të ligjshëm. Gjykata Supreme në lidhje me pretendimet e ngritura në plotësimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë përkitazi me kërkesat për përjashtim të prokurorit të çështjes dhe shkresat e tjera, për të cilat ka vendosur kryeprokurori përkatës konsideroi nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit para saj.

39. Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës në esencë pretendon se Aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë në: (i) shkelje të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit procedural, duke përfshirë pretendimet për përjashtimin e gjyqtarit dhe prokurorit të rastit; (ii) mosarsyetim të vendimit gjyqësor, duke përfshirë pretendimin për marrjen parasysh të rrethanave rënduese në caktimin e dënimit, sepse sipas tij veprat penale të mëhershme kanë arritur rehabilitimin ligjor. Rrjedhimisht, në vijim, Gjykata do t'i shqyrtojë ndaras pretendimet e lartcekura të parashtruesit të kërkesës.

#### **I. Përkitazi me pretendimet për shkeljen e parimit të barazisë së armëve**

40. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se prokurori në çështjen e tij, ka zhvilluar hetimet në mënyrë të njëanshme duke favorizuar të pandehurin tjetër D.M., dhe nuk ka ftuar mbrojtësin e tij gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve por vetëm mbrojtësin e të bashkëpandehurit të tij, pavarësisht se ai gjendej në paraburgim dhe në këto raste mbrojtja është e detyrueshme. Në këtë kontekst, i njëjti thirret në praktikën gjyqësore të Gjykatës në lidhje me parimin e barazisë së armëve.
41. Në ndërlidhje me këtë pretendim, Gjykata fillimisht vë në pah se parashtruesi ngrit çështje të shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me të drejtën e garantuar në pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 (E drejta për proces të rregullt) të KEDNJ-së, e cila përcakton si në vijim: “3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: [...] d. të pyesë ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës”. Pra, sipas këtij neni, përpara se një i akuzuar të dënohet, duhet që të gjitha provat kundër tij normalisht të paraqiten në praninë e tij në një seancë dëgjimore publike me qëllim të argumentimit kundërshtues.
42. Në vijim Gjykata do të shqyrtojë: (i) parimet e përgjithshme në lidhje me çështjen e ngritur nga parashtruesi i kërkesës, si dhe më pas do të bëjë (ii) aplikimin e tyre në rrethanat e rastit konkret.
- (i) *Parimet e përgjithshme në lidhje me barazinë e armëve në kontekst të marrjes në pyetje të dëshmitarëve në procedurë penale*
43. Gjykata rikujton se kriteret e përgjithshme përkitazi me të drejtën e të akuzuarit për të marrë në pyetje dëshmitarët kundër tij/saj janë elaboruar detajisht përmes praktikës gjyqësore të Gjykatës në rastet [KI14/18](#), parashtrues: *Hysen Kamberi*, Aktgjykim i 15 janarit 2020, paragrafët 47 deri 76, si dhe [KI113/21](#), parashtruese: *Bukurije Haxhimurati*, Aktgjykim i 20 dhjetorit 2021, paragrafët 115-121)
44. Sipas praktikës gjyqësore së GJEDNJ-së, të afirmuar edhe nga praktika e Gjykatës, përjashtimet nga ky parim janë të mundshme, por nuk duhet të cenojnë të drejtat e mbrojtjes, të cilat, si rregull, kërkojnë që të akuzuarit t'i jepet një mundësi adekuate dhe e duhur për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje një dëshmitar kundër tij, qoftë kur ai dëshmitar bën deklaratë ose në një fazë të mëvonshme të procedurës (shih rastet e GJEDNJ-së, [Al-Khawaja dhe Tahery kundër Mbretërisë së Bashkuar \[DHM\]](#), nr. 26766/05 dhe 22228/06, Aktgjykim i 15 dhjetorit 2011, paragrafi 118; [Hümmer kundër Gjermanisë](#), nr. 26171/07, Aktgjykim i 19 korrikut 2012, paragrafi 38; [Lucà kundër Italisë](#), nr. 47023/99, Aktgjykim i 31 tetorit 2001, paragrafi 39; [Solakov kundër Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), nr. 47023/99, Aktgjykim 31 tetorit 2001, paragrafi 57, si dhe

rastet e Gjykatës, [KI14/18](#), parashtrues *Hysen Kamberi*, cituar më lart, paragrafi 47 dhe KI113/21, parashtruese *Bukurije Haxhimurati*, cituar më lart, paragrafi 117). Këto parime janë veçanërisht të vërteta kur përdoren deklaratat e dëshmitarëve të marra gjatë hetimeve policore dhe hetimeve gjyqësore në një seancë dëgjimore ([Schatschaschwili kundër Gjermanisë \[DHM\]](#), nr. 9154/10, Aktgjykim i 15 dhjetor 2015, paragrafët 104-105).

45. GJEDNJ konsideron se si rregull i përgjithshëm, i takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë provat para tyre, si dhe rëndësinë e provave që të pandehurit kërkojnë të paraqesin. Sipas saj, pika d) e paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së ua lë atyre, përsëri si rregull i përgjithshëm, të vlerësojnë nëse është e përshtatshme të thërrasin dëshmitarë. GJEDNJ nuk kërkon pjesëmarrjen dhe marrjen në pyetje të çdo dëshmitari në emër të të akuzuarit; qëllimi i tij thelbësor, siç tregohet nga fjalët "në të njëjtat kushte", është "barazia e armëve" e plotë në këtë çështje ([Perna kundër Italisë \[DHM\]](#), nr. 48898/99, Aktgjykim i 6 majit 2003, paragrafi 29; [Murtazaliyeva kundër Russia \[DHM\]](#), nr. 36658/05, Aktgjykim i 18 dhjetorit 2018, paragrafi 139; [Solakov kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë](#), cituar më lart, paragrafi 57);
46. Tutje, GJEDNJ nënvizon se nuk mjafton që i pandehuri të ankohet se nuk i është lejuar marrja në pyetje disa dëshmitarëve; ai duhet, përveç kësaj, të mbështesë kërkesën e tij duke shpjeguar pse është e rëndësishme që dëshmitarët në fjalë të dëgjohen dhe provat e tyre duhet të jenë të nevojshme për vërtetimin e së vërtetës dhe të drejtave të mbrojtjes ([Perna kundër Italisë \[DHM\]](#), cituar më lart, paragrafi 29; [Băcanu dhe SC «R» S.A. kundër Rumanisë](#), nr. 4411/04, Aktgjykim i 3 marsit 2009, paragrafi 75). Nëse deklarata e dëshmitarëve që parashtruesi dëshironte të thërriste nuk mund të ndikonte në rezultatin e gjyqimit të tij ose të saj, nuk lind asnjë çështje sipas pikës d) të paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, nëse kërkesa për të dëgjuar dëshmitarë të tillë refuzohet nga gjykatat vendase ([Kapustyak kundër Ukrainës](#), nr. 26230/11, Aktgjykim i 3 marsit 2016, paragrafët 94-95).
- (ii) *Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret*
47. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës ishte ankuar për faktin se prokurori gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve në fazën e hetimeve ka ftuar vetëm mbrojtësin e të akuzuarit D.M., ndërsa për të nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 132 (Marrja e deklaratës në procedurë paraprak) të KPPRK-së duke vepruar në kundërshtim me parimin e barazisë së armëve në procedurë.
48. Lidhur me këtë pretendim, Gjykata thekson përmbajtjen e paragrafit 6 të nenit 132 të KPPRK-së, si në vijim: "Prokurori i shtetit e njofton me shkrim pesë (5) ditë më herët të pandehurin, mbrojtësin, të dëmtuarin dhe mbrojtësin e viktimave lidhur me datën, kohën dhe vendin ku do të merret deklarata në procedurë paraprake. Kopje e njoftimit i bashkëngjitet shkresave të lëndës." Megjithatë, Gjykata i referohet edhe paragrafit 2 të nenit 131 (Marrja në pyetje në procedurë paraprake) të KPPRK-së, ku përcaktohet se: "2. Prokurori i shtetit mund të lejojë mbrojtësin, viktimën apo mbrojtësin e viktimave që të marr pjesë në marrjen në pyetje në procedurë paraprake". Rrjedhimisht, Gjykata vëren se kjo dispozitë ligjore nuk përcakton shprehimisht që gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve të jetë i pranishëm mbrojtësi i të pandehurit, nëse këtë nuk e ka kërkuar specifikisht i njëjti.
49. Për më tepër, Gjykata gjithashtu rithekson faktin se më 11 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë kundër A.H., Prokuror në Prokurorinë Themelore me pretendimin se ky prokuror kishte trajtuar atë në mënyrë të pabarabartë në raport me të

pandehurin tjetër [D.M] dhe i njëjti ishte i anshëm, e cila ankesë u refuzua nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore përmes Vendimit [AD.nr.03/2021] të 29 qershorit 2021. Më specifikisht, Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore përmes Vendimit [AD.nr.03/2021] të 29 qershorit 2021 refuzoi ankesën disiplinore të parashtruesit të kërkesës, me arsyetimin se mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës është caktuar sipas detyrës zyrtare, pra, nuk ka qenë i autorizuar në bazë të autorizimit, dhe se i njëjti nuk ka paraqitur asnjë kërkesë të prokurorit që të merr pjesë gjatë marrjes së deklaratave të palëve duke përkujtuar se deklaratat e palëve të dhëna gjatë fazës së hetimeve mund të sfidohen nga i pandehuri dhe mbrojtësi i tij gjatë seancave gjyqësore, si dhe që pranueshmërinë e provave e vlerëson gjykata, ndërsa i pandehuri dhe mbrojtësi i tij mund t'i kundërshtojnë ato bazuar në nenin 249 të KPPRK-së. Ashtu siç është cekur në parimet më lart, kufizimet në parimin e barazisë së armëve nuk duhet të pengojnë mundësinë e të palës në procedurë për të komentuar apo kundërshtuar provat e lëndës.

50. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet edhe nenit 249 (Kundërshtimi i provave) të KPPRK-së, i cili nen është në pajtim me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit procedural si në vijim: *“1. Para shqyrtimit të dytë, i pandehuri mund të paraqesë kundërshtim ndaj provave të caktuara në aktakuzë, bazuar në këto arsye: 1.1. provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritar; 1.2. provat janë në kundërshtim me rregullat nga Kapitulli XVI i këtij Kodi; ose 1.3. ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thelbësisht të pambështetshme. 2. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që t'i përgjigjet kundërshtimit gojarisht ose me shkrim. [...] 5. Të gjitha provat kundër të cilave nuk është paraqitur kundërshtim janë të pranueshme në shqyrtim gjyqësor, përveç nëse gjykata sipas detyrës zyrtare përcakton se pranueshmëria e provës së caktuar do të cenonte të drejtat e të pandehurit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. [...]”*
51. Nga shkresat e lëndës të rastit konkret, rezulton se parashtruesi i kërkesës kishte pasur mundësi që të kundërshtojë provat, respektivisht, deklaratat e marra nga dëshmitarët pa praninë e mbrojtësit të tij, si dhe të marrë në pyetje të njëjtit në seancat gjyqësore të zhvilluara gjatë procedurës penale kundër tij. Më saktësisht, nga arsyetimi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore mund të kuptohet se dëshmitarët janë marrë në pyetje nga mbrojtësi i parashtruesit të kërkesës. Për më tepër, në lidhje me pretendimin e tij specifik për mospjesëmarrjen e mbrojtësit të tij gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve në fazën e hetimeve, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka argumentuar nëse ka kërkuar që mbrojtësi i tij të marrë pjesë gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarëve në këtë fazë të procedurës penale paraprake. Fakti se parashtruesi nuk ka kërkuar që mbrojtësi i tij të marrë pjesë në marrjen në pyetje të dëshmitarëve në këtë fazë, vërtetohet edhe nga Vendimi [AD.nr.03/2021] i 29 qershorit 2021, të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore, ku theksohet se i njëjti nuk ka parashtruar kërkesën e tillë. Për më tepër, Gjykata po ashtu nënvizon edhe faktin se parashtruesi në kërkesën e tij para saj, nuk specifikon saktësisht dëshmitarët, për të cilët konsideron se nuk janë marrë pyetje në prani të mbrojtësit të tij, duke lënë të përgjithësuar kështu pretendimin e tij.
52. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton edhe praktikën e lartcekur të GJEDNJ-së, e cila kërkon që të akuzuarit t'i jepet një mundësi adekuate dhe e duhur për të kundërshtuar dhe marrë në pyetje një dëshmitar kundër tij, qoftë kur ai dëshmitar bën deklaratë ose në një fazë të mëvonshme të procedurës, mundësi këto që parashtruesit të kërkesës nuk rezultojnë se iu kanë mohuar gjatë procedurës penale.

53. Thënë këtë, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me dëshmi pretendimin e tij se parimi i barazisë së armëve është shkelur gjatë procedurës penale në kuptimin e mohimit të drejtave kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin pikën d) të paragrafit 3 të nenit 6 të KEDNJ-së të KEDNJ-së, bazuar në parimet e elaboruara si më lart. Po ashtu, bazuar në elaborimin e arsytimit të vendimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore, si dhe sipas dispozitave konkrete ligjore të lartpërmendura, rezulton se pretendimet respektive të parashtruesit të kërkesës janë adresuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
54. Si rrjedhojë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit të kërkesës që do të arsyetonte konstatimin se janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Prandaj, Gjykata konsideron se pretendimet e tij për shkelje të parimit të barazisë së armëve janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese në *“mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”* ashtu siç është përcaktuar me paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës.
55. Ndërsa, përkitazi me pretendimin në lidhje me shqyrtimin e kërkesës së parashtruesit për përjashtimin e gjyqtarit në rastin e tij, me ç’rast ishte ankuar edhe për prokurorin e çështjes, Gjykata rithekson se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [AGJ.I.nr.167/21] të 18 qershorit 2021, e refuzoi si të pabazuar këtë kërkesë me arsytimin se pretendimet e parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë me çështje procedurale, që mund të jenë objekt i shqyrtimit me rastin e vendosjes sipas ankesës dhe se kjo nuk përbën arsye për përjashtim të gjyqtarit, për më tepër, nënvizon faktin se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [PML.nr.187/21] të 25 majit 2021 kishte pranuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, me ç’rast kishte ndërprerë masën e paraburgimit për parashtruesin duke e lëshuar të mbrohet në liri.
56. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 6 të nenit 9 (Ankesat ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkelje disiplinore) të Ligjit për procedurën disiplinore, i cili përcakton se brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i ankesës për shkelje disiplinore ndaj një prokurori apo gjyqtari, Autoriteti kompetent trajton atë dhe fillon hetimin disiplinor, përveç kur konstaton se ankesa është dukshëm joserioze, e pabazuar, nuk ka të bëjë me ndonjë shkelje disiplinore, ose është parashkruar. Në këtë rast, Ligji për procedurën disiplinore nuk ka paraparë të drejtën për t’u ankuar ndaj Aktvendimit për hedhjen poshtë të ankesës disiplinore. Në kontekst, Gjykata i referohet edhe paragrafit 3 të nenit 42 të KPPRK-së, i cili përcakton se: *“3. Kundër aktvendimit me të cilin pranohet kërkesa për përjashtim nuk lejohet ankesë. Aktvendimi me të cilin kërkesa për përjashtim refuzohet mund të kundërshtohet me ankesë të posaçme, e kur një aktvendim i tillë është marrë pas ngritjes së aktakuzës, atëherë mund të kundërshtohet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit.*
57. Meqenëse, në kohën e paraqitjes së kërkesës për përjashtim të gjyqtarit, ishte ngritur aktakuza, ndaj Aktvendimit [AGJ.I.nr.167/21] të 18 qershorit 2021 të Gjykatës Themelore, nuk ishte lejuar ankesa, siç u evidentua në këshillën juridike të këtij aktvendimi. Megjithatë, Gjykata vëren se sipas kësaj dispozite ligjore, kundërshtimi për refuzimin e përjashtimit të gjyqtarit, mund të kundërshtohet me ankesë kundër aktgjykimit.
58. Në rastin konkret, Gjykata vë në dukje se parashtruesi i kërkesës në ankesën e tij të 2 qershorit 2022, kundër Aktgjykimit [P.nr. 195/21] të 14 prillit 2022, të Gjykatës Themelore, nuk ishte ankuar për refuzimin e kërkesës për përjashtim të gjyqtarit apo prokurorit në fjalë. Ai nuk kishte ngritur këtë pretendim as para Gjykatës Supreme përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, të dorëzuar më 27 prill 2023. Gjykata rikujton se parashtruesi në

lidhje me pretendimet për përjashtimin e prokurorit përkatës dhe paanësisë së tij, por jo edhe të gjyqtarit, më 12 maj 2023, kishte parashtruar edhe një parashtrësë për plotësimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit dhe se në lidhje me këto pretendime, Gjykata Supreme më 30 maj 2023, përmes Aktgjykimit [Pml.nr. 201/2023], arsyetoi si në vijim: “[...] kjo gjykatë gjen se shkresat e bashkëngjitura janë lidhur me çështje të cilat kanë përfunduar dhe të cilat nuk mund të jenë objekt i shqyrtimit pranë kësaj gjykatë, megjithëse kanë të bëjnë me kërkesat për përjashtim të prokurorit të çështjes dhe për të cilat ka vendosur kryeprokurori përkatës”.

59. Në këtë kontekst, Gjykata thekson se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet vetëm për arsytet e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 432 (Arsyet për paraqitje të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë) të KPPRK-së, si në vijim: “1.1. në rast të shkeljes së ligjit penal; 1.2. në rast të shkeljes esenciale të ligjit të procedurës penale nga neni 384, paragrafi 1. i këtij Kodi; ose 1.3. në rast të shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.”, e të cilat në rrethanat e rastit konkret qartazi nuk zbatohen për shkak se pretendimi ka të bëjë me përjashtimin e prokurorit dhe jo të gjyqtarit, e cila çështje është jashtë juridiksionit të gjykatave sipas nenit 44 të KPPRK-së, apo paragrafit 4 të nenit 43 (Bazat për përjashtimin e prokurorëve të shtetit) të Kodit të ri [Nr. 08/L-032] të Procedurës Penale, i cili ishte i aplikueshëm në kohën kur Gjykata Supreme nxjerri aktgjykimin e saj të lartcekur.
60. Duke qenë se parashtruesi nuk kishte ngritur formalisht por as në substancë/përmbajtje pretendimin për përjashtim të gjyqtarit përkatës para Gjykatës së Apelit, por as Gjykatës Supreme, Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore dhe asaj të GJENDJ-së, sa i përket kriterit për shterjen e mjeteve juridike në kuptimin substancial, dhe rikujton se në rrethana të tilla, pretendimet e tilla nuk mund të shqyrtohen nga Gjykata për mungesë të shterimit të mjeteve juridike në kuptim substancial. Bazuar në po të njëjtën praktikë gjyqësore, Gjykata kishte refuzuar shqyrtimin e pretendimeve përkatëse sepse të njëjtat nuk ishin ngritur asnjëherë para gjykatave të rregullta, ndër të tjera, edhe në rastet e Gjykatës, [KI119/17](#), parashtrues *Gentian Rexhepi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 3 majit 2009, paragrafi 71, [KI154/17 dhe KI05/18](#), parashtrues *Basri Deva, Aferdita Deva dhe Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "BARBAS"*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 korrikut 2019, paragrafi 92, [KI155/18](#), parashtrues *Benson Buza*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shtatorit 2019, paragrafi 50, [KI163/18](#), parashtrues *Kujtim Lleshi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 24 qershorit 2020, paragrafi 59 dhe [KI40/20](#), parashtrues *Sadik Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 20 janarit 2021, paragrafi 66.
61. Gjykata rithekson se shterimi i mjeteve juridike ndërthen në vete dy elemente: (i) atë të shterimit në kuptimin formal-procedural, që nënkupton mundësinë e përdorimit të mjetit juridik, kundër një akti të një autoriteti publik, në një instancë më të lartë me juridiksion të plotë; dhe (ii) shterimin e mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “substancë” para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ. Gjykata i konsideron si të shterura mjetet juridike vetëm atëherë kur parashtruesit e kërkesës, në pajtueshmëri me ligjet në fuqi, i kanë shfrytëzuar ato, në të dy kuptimet. (Shih, po ashtu, rastet e Gjykatës, [KI71/18](#), parashtrues, *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 nëntorit 2018, paragrafin 57; rastin [KI119/17](#), cituar më lart, paragrafin 73; rastin [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 94; dhe rastin [KI163/18](#), cituar më lart, paragrafi 61; [KI40/20](#), cituar më lart, paragrafi 67).

62. Një qëndrim i tillë është në përputhshmëri të plotë me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, bazuar në të cilën, për aq sa ekziston një mjet juridik që ua mundëson gjykatave të rregullta të adresojnë, të paktën në substancë, argumentin për shkelje të një të drejte, atëherë ai mjet juridik duhet të shfrytëzohet. Nëse ankesa e paraqitur në Gjykatë nuk është ngritur, qoftë në mënyrë eksplicite apo në substancë, pranë gjykatave të rregullta kur ka mundur të ngrihet gjatë ushtrimit të një mjete juridik në dispozicion të parashtruesit të kërkesës, atëherë gjykatave të rregullta u është mohuar mundësia e adresimit të çështjes, mundësi të cilën rregulli për shterimin e mjeteve juridike synon ta ofrojë (shih, ndër tjerash, rastin e GJEDNJ-së, [Jane Nicklinson kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Paul Lamb kundër Mbretërisë së Bashkuar](#), nr. 2478/15 dhe nr.1787/15 Vendim në lidhje me pranueshmërinë i 23 qershorit 2015, paragrafi 90 dhe referencat e përfshira aty; dhe shih, gjithashtu, rastin e Gjykatës, KI119/17, cituar më lart, paragrafin 72; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 93; rastin KI155/18, cituar më lart, paragrafi 49; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 60; dhe KI40/20, cituar më lart, paragrafi 67).
63. Marrë parasysh këto parime dhe në rrethana në të cilat, sipas shkresave të lëndës rezultojnë se këto pretendime specifike të parashtruesit të kërkesës janë ngritur për herë të parë para Gjykatës, ajo konkludon që parashtruesi i kërkesës nuk i ka dhënë mundësinë Gjykatës së Apelit dhe asaj Supreme, që të adresojnë këto pretendime dhe me atë rast, të parandalojnë shkeljet e pretenduara që parashtruesi i kërkesës i ngrit drejtpërdrejt pranë kësaj Gjykate, pa i shteruar mjetet juridike në kuptimin e tyre substancial (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, [KI118/15](#), parashtrues *Dragiša Stojković*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 prillit 2016, paragrafët 30-39; rastin KI119/17, cituar më lart, paragrafi 74; rastin KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 95; dhe rastin KI163/18, cituar më lart, paragrafi 62).
64. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se pretendimi përkitazi me përjashtimin e gjyqtarit duhet të refuzohet si i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën b) të paragrafit 1 të rregullit 34 të Rregullores së punës.
65. Në anën tjetër, përkitazi me pretendimin e përjashtimit të prokurorit, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar argumente dhe dëshmi për të mbështetur atë si në kuptimin e mohimit të drejtave kushtetuese të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, bazuar në parimet dhe dispozitat e elaboruara si më lart, andaj, Gjykata konsideron se ky pretendim është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese në kategorinë e pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” siç përcaktohet në nenin 48 të Ligjit dhe pikën d) të paragrafit 1 dhe paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës.

## II. Përkitazi me pretendimin për shkeljen e të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor

66. Përkitazi me pretendimin për mosarsyetim të vendimit gjyqësor, Gjykata ripërsërit pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Themelore në aktgjykimin e saj nuk ka trajtuar fare kundërshtimet e mbrojtjes se cilat kanë qenë veprimet e parashtruesit të kërkesës përmes të cilave ka kryer veprën penale, për të cilën është gjykuar dhe shprehet se: “*Gjykata Themelore në Gjakovë në Aktgjykimin e saj fare nuk ka trajtuar kundërshtimet e mbrojtjes se cilat kanë qenë veprimet e të akuzuarit, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PA1.nr.1732/2022, të datës 05.04.2023, fare nuk ka trajtuar asnjë pretendim të mbrojtjes për veprimet e parashtruesit të kërkesës që e bëjnë kryes të kësaj vepre, ndërsa Gjykata*

*Supreme nuk është thirrur në kundërshtimet e sa i përket administrimit të provave, mos administrimit të deklaratës së dëshmitarit [P.Th] e cila ka qenë tërësisht shfajësuese. Ndërsa lëshimi i saj në gjendje faktike ka qenë totalisht i gabuar dhe jo kompetencë e saj*” Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi konsideron se aktgjykimet e kontestuara kanë shkelur parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje ngase arsyetimet e dhëna nuk përmbajnë fakte të vërtetuara, dispozitat ligjore përkatëse dhe marrëdhënien logjike midis tyre, dhe për këtë mbështetet në praktikën gjyqësore të Gjykatës, duke përmendur disa raste specifike të saj. Në këtë kontekst, Gjykata thekson pretendimin e parashtruesit të kërkesës në lidhje me llogaritjen e lartësisë së dënimit, për të cilin pretendon se janë marrë parasysh vepra penale të cilat kanë qenë dashur të fshihen *ex-lege* dhe vepra të cilat nuk prodhojnë pasoja. Më specifikisht, ai përmend se rrethanë rënduese i është llogaritur dënimi me 2 (dy) vite me kusht, i shqiptuar me Aktgjykimin [PKR.nr.421/12] të 27 nëntor 2013 i Gjykatës Themelore, për të cilin dënim konsideron se ka arritur rehabilitimin ligjor më 9 shkurt 2018.

67. Në vijim Gjykata do të shqyrtojë (i) parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor, si dhe më pas do të bëjë (ii) aplikimin e tyre në rrethanat e rastit konkret.

(i) *Parimet e përgjithshme në lidhje me të drejtën për vendim të arsyetuar gjyqësor*

68. Në *parim*, Gjykata rithekson se garantitë e mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykim i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastet e Gjykatës [KI230/19](#), me parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 139 dhe rastin [KI87/18](#), me parashtrues *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44 dhe [KI143/22](#), parashtrues *Hidroenergjia sh.p.k*, Aktgjykim, i 15 dhjetorit 2022, paragrafi 113). Vendimi i arsyetuar gjyqësor u tregon palëve se rasti i tyre është shqyrtuar me të vërtetë.

69. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore, gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesve të kërkesës që duhet të adresohen dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikuashëm (shih në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNJ-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim, i 29 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykim i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës [KI97/16](#), me parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 4 dhjetorit 2017, paragrafi 48; dhe rastin [KI87/18](#), me parashtrues *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih rastin *Moreira Ferreira kundër Portugalisë*, Aktgjykim i 5 korrikut 2011, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përdorura aty; si dhe rastet e Gjykatës [KI230/19](#), parashtrues *Albert Rakipi*, cituar më lart, paragrafi 137, [KI107/21](#), me parashtrues *Ramiz Hoti*, cituar më lart, paragrafët 69).

(ii) *Aplikimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret*

70. Në vlerësimin e pretendimit të parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljen e të drejtës për vendim të arsyetuar gjyqësor, Gjykata fillimisht vë në pah arsyetimin e Aktgjykimit [P.nr.195/2021] të 14 prillit 2022 të Gjykatës Themelore, e cila theksoi, ndër të tjera, se: *“1. Gjykata të dëmtuarën e ka marrur në pyetje me anë të skype edhe pse e njëjta ishte në gjykatë por në një sallë tjetër, me arsyetimin se të dëmtuarën në një seancë paraprake ka filluar që ta merr në pyetje në sallë të gjykimit kur ishin të gjitha palët, por e dëmtuara ka pasur frik, shqetësim dhe emocion, pastaj mbrojtësja e viktimave e ka bërë një kërkesë që e dëmtuara të qëndrojë në një sallë tjetër dhe gjykata e ka aprovuar kërkesën; 2. Gjykata e ka aprovuar kërkesën e të akuzuarit [N.B] që si dëshmitar të ftohet bashkëshortja e tij [B.B], të njëjtën gjykata e ka dëgjuar në cilësi të dëshmitares, por të njëjtën disa nga palët në procedurë nuk e kanë pyetur me arsyetimin se ka qenë e pranishme në seanca, e gjykata e ka aprovuar pasi që dëshmitarja ka qenë prezent në seancat : fillestare dhe shqyrtimi i dytë, si qytetare; 3. Gjatë mbrojtjes së të pandehurit [N.B], gjatë marrjes në pyetje nga prokurori i shtetit, gjykata i ka lejuar të gjitha pyetjet e parashtruara nga prokurori në drejtim të pandehurit kanë qenë të tërthorta, se të gjitha pyetjet janë parashtruar duke u ndërlidhur me deklaratat e të pandehurit të cilat i ka dhënë në: Polici dhe Prokurori e i pandehuri nuk është përgjigjur asnjëherë as në polici e as në prokurori.”*

71. Në anën tjetër, Gjykata thekson se Gjykata e Apelit në Aktgjykimit [PA1.nr.1732/22] të 16 shkurtit 2023 arsyetoi si në vijim:

*“Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përkrahur gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar. Gjykata e shkallës së parë provat i ka vlerësuar në pajtim me dispozitat e nenit 361 par.2 të KPPK-së, kurse për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par. 6 dhe 7 të KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe çfarë arsye i merr si të provuara dhe të pa provuara. Ajo ka dhënë arsye në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së çështjes juridike penale, veçanërisht të ekzistimit të përgjegjësisë penale të të akuzuarit. Në arsyetimin e aktgjykimit përkitazi me ngjarjen e kryerjes së veprës penale në fjalë, janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje juridike penale, të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe një herë vlerësimin për këtë. Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë edhe me mbrojtjen e të akuzuarit [N.B], kështu që përfundimet e gjykatës së shkallës së parë sa i takon mbrojtjes së të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate janë të drejta dhe të bazuara me ligj. [...]*

72. Gjykata vëren gjithashtu se Gjykata e Apelit adresoi pretendimet specifike të parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera (i) në lidhje me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike se aktgjykimi ishte bazuar në thashetheme, (ii) faktin se edhe ndihma në kryerjen e veprës penale është një ndër format e bashkëveprimimit – bashkëkryerjes së një vepre penale, e cila është vërtetuar në rastin konkret, (c) pjesëmarrjen e bashkëshortes së parashtruesit në seancën fillestare dhe të dytë të shqyrtimit; (d) cenimin e parimit të barazisë së palëve në procedurë penale dhe (f) matjen e lartësisë së dënimit.

73. Gjykata vë në dukje edhe arsyetimin e Gjykatës Supreme në Aktgjykimin [Pml. Nr. 201/2023] të 30 majit 2023, ku theksohet se: *“Gjykata Supreme e Kosovës pasi që vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë si dhe duke u bazuar në shkresat e çështjen gjen se aktgjykimet nuk janë të përfshira në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të pretenduara meqenëse aktgjykimet janë përpiluar konform dispozitave të procedurës*

*penale si dhe në aktgjykime janë dhënë arsyetime ligjore dhe të qarta lidhur me të gjitha provat e vlerësuara si ato fajësuese dhe ato shfajësuese e mbi bazën e të cilave është marrë vendimi mbi fajësinë e të dënuarit. Po ashtu kjo gjykatë gjen se gjykata e shkallës së dytë ka adresuar të gjitha pretendimet ankimore të mbrojtësit të paraqitura kundër aktgjykimit të shkallës së parë andaj edhe në këtë drejtim nuk ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale”.*

74. Tutje, Gjykata Supreme arsyetoi edhe në lidhje me vërtetimin e gjendjes faktike duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve A.B., dhe M.T., si dhe të dëmtuarës L.B. Në këtë arsyetim, Gjykata Supreme gjithashtu konstatoi se Gjykata e Apelit gabimisht kishte kualifikuar “*ndihmën në kryerjen e veprës penale si formë të bashkëveprimit-bashkëkryerjes*”, pasi që veprimi i “*ndihmës*” që kishte kryer parashtruesi i kërkesës, sipas kësaj gjykate në të vërtetë përbënte element të figurës së veprës penale për të cilën ishte shpallur fajtor. Megjithatë, e njëjta konsideroi se ky konstatim i gjykatës më të ulët nuk kishte rënduar pozitën e të dënuarit dhe nuk kishte ndikuar as në llojin apo lartësinë e dënimit, duke refuzuar kështu kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës.
75. Gjykata, bazuar në parimet e përgjithshme përkitazi me të drejtën në një vendim të arsyetuar gjyqësor e të shtjelluara më lart, rikujton se në adresimin e pretendimeve të parashtruesve përkatës, gjykatat e rregullta, janë të detyruara që të japin përgjigje, ndër të tjera, lidhur me ato pretendime të cilat janë thelbësore ose përcaktuese për rrethanat e një rasti.
76. Gjykata vëren se në thelb, gjykatat e rregullta parashtruesin e kërkesës e kishin shpallur fajtor për veprën penale “*Mundësim i prostitucionit*”, duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve relevant dhe të dëmtuarës. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, përkatësisht lidhur me pretendimin për mos shqyrtimin e pretendimeve të mbrojtjes dhe administrimit të pasaktë të provave, përfshirë deklaratave të dëshmitarëve, Gjykata vëren se të njëjtat ishin trajtuar në mënyrë të mjaftueshme nga gjykatat e rregullta, duke shpjeguar raportin midis fakteve të paraqitura dhe zbatimit të bazës ligjore në të cilin ajo është thirrur, gjegjësisht në çfarë mënyre ato vijnë në korrelacion me njëra tjetrën.
77. Bazuar në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtruesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e procedurës dhe përmbajtjen e vendimeve të gjykatave të rregullta, nuk është i mjaftueshëm për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih rastin e Gjykatës, [KI136/14](#), parashtrues *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33 dhe [KI135/22](#), parashtrues *Nevruz Berisha*, cituar më lart, paragrafi 55).
78. Thënë këtë, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet se procedurat përkatëse në ndonjë mënyrë ishin të padrejta apo arbitrare. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, i përkasin kategorisë së pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj të njëjtat në baza kushtetuese duhet shpallur qartazi të pabazuara ashtu siç përcaktohet në nenin 48 të Ligjit dhe pikën d) të paragrafit 1 dhe paragrafin 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës.
79. Ndërsa, në lidhje me adresimin e pretendimit specifik të parashtruesit të kërkesës për matjen e lartësisë së dënimit në kundërshtim me dispozitat e KPRK-së për rehabilitimin ligjor, Gjykata ofron arsyetimin si në vijim.

80. Fillimisht, Gjykata vëren se në lidhje me lartësinë e dënimit, Gjykata Themelore ka marrë për bazë të kaluarën kriminale të parashtruesit të kërkesës si përsëritës i veprave penale, respektivisht, të 4 (katër) veprave penale sipas lëndëve penale si në vijim: (i) lënda [P.nr.95/13], dënim me gjobë i formës së prerë më 19 maj 2014 për veprën penale nga paragrafi 1 i nenit 252 (Vjedhja) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: ish KPPK); (ii) lënda [PKR.421/2012] dënim me kusht 1 (një) vit nëse brenda 2 (dy) viteve nuk kryhet vepër penale, i formës së prerë 9 shkurt 2019 për veprën penale nga paragrafi 1 i nenit 201 (Mundësim i prostitucionit) të ish KPPK-së; (iii) lënda [P.nr. 71/2018], dënim me kusht 3 (tre) muaj nëse brenda 1 (një) viti nuk kryhet vepër penale e re, i formës së prerë më 12 dhjetor 2019 për veprën penale nga paragrafi 1 i nenit 333 (Asgjësimit apo dëmtimit i pasurisë) të Kodit 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës; dhe (iv) lënda [P.nr.446/2021], dënim me gjobë i formës së prerë më 17 janar 2022, për veprën penale nga paragrafi 1 i nenit 181 (Kanosja) të KPRK-së.
81. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se në ankesën e parashtruesit të kërkesës, së 31 majit 2022, i njëjti kishte pretenduar se: *“Si rrethanë rënduese në vlerësimin e lartësisë së dënimit gjykata ka marrë parasysh të kaluarën kriminale time, Të cilat vepra pa përjashtim nuk prodhojnë pasojë, dhe këtë duke pasur parasysh nenin 93 të KPRK-së ku thuhet se “Pasojat juridike të dënimit nuk krijohen kur kryesit i shqiptohet gjobë apo vërejtja gjyqësore”. Ndërsa sa i përket dënimeve me kusht të cekura për të mbrojturin tim ka arritur Rehabilitimi ligjor në bazë të nenit 96, par 2 nën par 2.2 të KPRK-së. Pra, gjitha veprat e cekura nuk prodhojnë kurrfarë pasojash.”*
82. Në lidhje me këtë pretendim, Gjykata nënvizon arsyetimin e Gjykatës së Apelit në të cilin theksohet se: *“[...] gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesat e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do të arsyetonte shqiptimin e një dënimi tjetër ndaj të akuzuarve [...]. Arsyetimi i tillë vijon duke saktësuar veprat penale të mëhershme që janë marrë parasysh nga Gjykata Themelore në vlerësimin e lartësisë së dënimit.*
83. Tutje, Gjykata po ashtu thekson se në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së 27 prillit 2023, por edhe në plotësimin e kësaj kërkeje të dorëzuar nga parashtruesi i kërkesës më 12 maj 2023, ai nuk e kishte ngritur specifikisht para Gjykatës Supreme pretendimin për llogaritjen e kundërligjshme të lartësisë së dënimit. Rrjedhimisht, Gjykata vëren se edhe në arsyetimin e Gjykatës Supreme mungon sqarimi në lidhje me këtë çështje.
84. Në pajtim me parimet e përgjithshme në lidhje me mosshkrimin substancial të mjeteve juridike, të elaboruara më lart, Gjykata rikujton se kriteri i shterimit të mjeteve juridike, përveç (i) shterimit të mjeteve juridike në kuptimin formal, përfshin edhe elementin (ii) e shterimit të mjetit në kuptimin substancial, që nënkupton raportimin e shkeljeve kushtetuese në “*substancë*” para gjykatave të rregullta në mënyrë që këto të fundit të kenë mundësinë e parandalimit dhe të korrigjimit të shkeljes së të drejtave të njeriut të mbrojtura me Kushtetutë dhe KEDNJ (Shih, rastet e Gjykatës, [KI71/18](#), parashtrues, *Kamer Borovci, Mustafë Borovci dhe Avdulla Bajra*, cituar më lart, paragrafin 57; rastin [KI119/17](#), cituar më lart, paragrafin 73; rastin [KI154/17](#) dhe [KI05/18](#), cituar më lart, paragrafi 94; dhe rastin [KI163/18](#), cituar më lart, paragrafi 61; [KI40/20](#), cituar më lart, paragrafi 67).

85. Duke qenë se parashtruesi i kërkesës nuk e ka ngritur këtë pretendim para Gjykatës Supreme, Gjykata konsideron se parashtruesi nuk ia mundësuar asaj që si gjykatë e rregullt t'ia adresojë/korrigjojë, të paktën në substancë, argumentin për shkeljen e të drejtave të tij gjatë llogaritjes së lartësisë së dënimit për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.
86. Si rrjedhojë, Gjykata konstaton se pretendimi përkitazi me llogaritjen e kundërligjshme të lartësisë së dënimit duhet të refuzohet si i papranueshëm në baza procedurale për shkak të mosshterimit substancial të të gjitha mjeteve juridike, siç kërkohet me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, paragrafin 2 të nenit 47 të Ligjit dhe pikën b) të paragrafit 1 të rregullit 34 të Rregullores së punës.

### **Kërkesa për masë të përkohshme**

87. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës kërkon caktimin e masës së përkohshme, përkatësisht kërkon shtyrjen e ekzekutimit të dënimit të tij.
88. Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, që parashikon se:
- “1. Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.*
- 2. Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale.”*
89. Gjykata në rastin konkret ka shpallur kërkesën të papranueshme në pajtim me paragrafin 2 të nenit 47 dhe nenin 48 të Ligjit dhe me pikat b) dhe d) të paragrafit 1 dhe paragrafit 2 të rregullit 34 të Rregullores së punës.
90. Rrjedhimisht, Gjykata refuzon kërkesën për caktimin e masës së përkohshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20, 27, 47 dhe 48 të Ligjit, dhe me pikat b) dhe d) të paragrafit 1 dhe paragrafit 2 të rregullit 34, pikën b) të paragrafit 2 të rregullit 45, si dhe pikën b) të paragrafit 1 të rregullit 48 të Rregullores së punës, më 16 korrik 2024:

### VENDOS

- I. TË SHPALLË, njëzëri, kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË, njëzëri, kërkesën për masë të përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- V. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtari raportues

  
Bajram Ljati



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

  
Gresa Caka-Nimani